

# **Deklaratë Personale mbi Statusin e Vaksinimit dhe Infektimit**

**drejtuar institucionit arsimor kërkues të informacionit mbi statusin tim personal të vaksinimit**

## **Drejtuar:**

---

Ju më keni kërkuar informacion për të treguar nëse unë jam i vaksinuar apo jo.

Ky informacion është me karakter shëndetësor, konsiderohet nga legjislacioni shqiptar për ruajtjen e të dhënave personale dhe sdms ato shëndetësore, si informacion privat dhe sensitiv, sekretet dhe është ekskluziv dhe nuk mund të kërkohej nga institucione që nuk janë të autorizuara dhe të njohura nga legjislacioni.

Në rastet që ligji autorizon kërkimin e këtij informacioni duhet të çitohet baza ligjore e të drejtës së institucionit për grumbullimin e këtyre të dhënave sensitive dhe të mbrojtura me karakter shëndetësor dhe po ashtu duhet të ofrohet garancia e çituar e administrimit të këtyre të dhënave personale.

Në rastin konkret nuk më ofrohet asnjë referencë ligjore për të drejtën e mbledhjes së këtyre të dhënave nga institucioni juaj dhe as mbi garantimin e administrimit të tyre në bazë të legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale. Në rast se ju keni hapësirë ligjore për të kërkuar këto të dhëna, jeni të lutur të na veni në dispozicion referencën ligjore ku çitohet e drejta juaj për ta mbledhur dhe administruar këto të dhëna.

Ndërkohë nëse dikush është i vaksinuar, kjo e dhënë është e administruar ekskluzivisht nga autoritetet shëndetësore dhe veç ato kanë të drejtë ta marrin dhe ta administrojnë këtë të dhënë.

Për këtë arsye jam në pritje që të më vihet në dispozicion akti bashkë me referencën ligjore se ju jeni të autorizuar nga ligji për mbledhjen dhe administrimin e të dhënave konkrete mbi statusin e vaksinimit të personit tim (apo anëtarëve të familjes) dhe për këtë arsye, për momentin nuk mund të marr në konsideratë t'ju vë në dispozicion apo jo këto të dhëna që ju kërkoni.

Nëse këto të dhëna ua kërkon Ministria e Shëndetësisë apo institucionet e tjera shëndetësore, ju bëj me dije se i gjithë procesi i vaksinimit administrohet nga ata dhe kanë çdo informacion që duhet.

Gjithashtu dua t'ju bëj me dije, se asnjë institucion nuk ka asnjë arsye të ketë interes të dijë statusin tim të vaksinimit sepse si i vaksinuar si i pavaksinuar, të gjithë janë njësoj potencialisht infektues ndaj të tjerëve në rast se infektohen (dhe të dy palët janë njësoj të infektueshëm). Ky fakt konfirmohet sot nga të gjitha institucionet shkencore dhe mjekësore kudo në botë dhe tashmë është bërë publik edhe në media që të qënit i vaksinuar apo jo është veç avantazh apo disavantazh i përballimit personal me infektimin por s'ka asnjë ndikim të përhapjen ose jo të infeksionit.

Për këtë arsye njohuria se dikush është vaksinuar apo jo nuk përbën asnjë interes që ka të bëjë me mbrojtjen e shëndetit publik dhe rrezikun ose jo të përhapjes së infektimit.

Në rast se institucionet shëndetësore ju kanë kërkuar ju që të më kërkohej një vërtetim mjekësor nëse unë jam i infektuar apo jo, kërkoj të më ofrohet edhe orientimi ligjor, informativ dhe financiar se cili subjekt publik apo privat ma ofron këtë mundësi konform të drejtave të mia si person i painteresuar personalisht por i detyruar nga ju për ta siguruar një vërtetim të tillë. Duke qenë se unë jam pagues i rregullt i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, kërkoj të më jepet informacion se ku duhet të paraqitem për të marrë një vërtetim të tillë konform të drejtave të mia në marrëdhëniet e punës si person që i garantohen shërbimi falas për marrje vërtetimesh të kërkuara nga institucioni jashtë kushteve të kontratës

së punës (kjo gjë nuk është parashikuar në kontratën e marëdhënies së punës). Ju kujtoj se marrja e analizave të tilla kushton në sektorin privat shëndetësor në shifra që variojnë mbi 35 euro dhe në rast se do të më kërkoheshin të tilla të dhëna çdo 3 ditë do të më kushtonin 280-325 euro në muaj apo 140-175 euro në muaj, shifër kjo e papërbalueshme referuar të ardhurave personale.

Ju kërkohet të njihem me faktin nëse kjo më kërkohet veç mua apo çdo kujt të pavaksinuar apo të vaksinuar pa dallim apo me dallim diferencues. Në rast se kjo u kërkohet veç personave të pavaksinuar, atëherë ju kujtoj që kjo kërkesë e juaja është në kundërshtim me ligjin për mbrojtjen kundër diskriminimit dhe Kushtetutën e Shqipërisë, Kodin e Punës (dhe Legjislacionin për Arismin) për shkak se personat e pavaksinuar po trajtohen në mënyrë diskriminuese duke u kërkuar të vërtetojnë gjëndjen e tyre shëndetësore infektuese ose jo ndërkohë që kjo nuk u kërkohet personave të vaksinuar që gjithashtu janë potencialisht të infektueshëm dhe për pasojë infektues. Statusi i vaksinimit ose jo, referuar të dhënave zyrtare shkencore dhe të pohuara publikisht nga mjekë dhe shkencëtarët e fushës, nuk ndikon aspak në infektimin dhe të qenit infektues dhe siç përdoret gjerësisht termi shkencor “Personat e vaksinuar kanë të njëjtën ngarkesë virale me personat e pavaksinuar”.

Për këtë arsye ju kujtoj se në bazë të Nenit 1 të Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “për mbrojtjen nga diskriminimi” që askush nuk mund të diskriminohet për shkaqe “të gjëndjes shëndetësore”, “predispozitave gjenetike”, “përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Gjithashtu dua t’ju kujtoj se personat që e kanë kaluar infeksionin, kanë imunitet të paktën 10 herë më të lartë se personat e vaksinuar dhe testet serilogjike sipas standardeve që po aplikohen, nuk paraqesin të dhëna të mjaftueshme. Për këtë arsye ju kujtoj se duke qenë se si personat që kanë kaluar virusin dhe ata që se kanë kaluar, si ata që janë vaksinuar dhe ata që nuk janë vaksinuar, është jo vetëm e pakuptimtë që personat e pavaksinuar të trajtohen në mënyrë të diferencuar, por është edhe diskriminim i pastër ligjor i dënueshëm nga nga legjislacioni shqiptar.

Madje duke qenë se alternativa e ofruar për një kategori personash me të ardhura të ulëta, është humbja e të drejtës së studimit ose lënia e të ardhurave familjare në disa shpenzime të panevojshme si këto letra që nuk vlejnë, ata mund të detyrohen që të pranojnë të vaksinohen nga kushtet shtrënguese që u vendosën, por kjo do ta çonte çështjen në konsiderimin si krime kundër njerëzimit referuar Kodit të Nurembergut (1947) pasi po shtrëngohen njerëzit që të bëhen subjekte të barnave eksperimentale (kujtojmë se vaksinimi ndodhet në fazën e tretë të observimit pra është në periudhë monitorimi) dhe çdo kush që implikohet në këtë mekanizëm, nesër do të jetë subjekt i gjykimeve për krime kundër njerëzimit në fushën mjekësore.

**Deklaroj se këtë tekst e kanë formuluar avokatë të të drejtave të njeriut të specializuar në çështjet që kanë të bëjnë me Kodin e Nurembergut, Legjislacionin për të drejtat e njeriut, mbrojtjen e të dhënave personale, legjislacionin shëndetësor, të Etikës dhe Deontologjisë së Mjekësisë, dhe unë e firmos me vullnetin tim të plotë i vendosur që të bashkëpunoj ngushtësisht me institucionet konform ligjit dhe parimeve të përgjithshme të njohura ndërkombëtarisht të së Drejtës.**

**Emri** \_\_\_\_\_ **Mbiemri** \_\_\_\_\_ **Firma:** \_\_\_\_\_

**Kontakt:** \_\_\_\_\_

**Data** \_\_\_\_\_ **Vendi:** \_\_\_\_\_